

VENDIM
Nr. 221, datë 30.9.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 195, DATË 30.8.2018,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘DERBI-E’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘ANTENA’ ME FUQI TË
INSTALUAR 1105 kw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.9.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e Bordit të ERE-s, lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 195, datë 30.8.2018, i ndryshuar me vendimin nr. 257, datë 23.8.2023, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me kapacitet të instaluar 1105 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vendimin nr. 195/2018, i ndryshuar, në pikën 2 është përcaktuar se:

“Shoqëria ‘Derbi-E’ sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE: kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Mat, jo më vonë se data 7.4.2033, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti, si dhe lejen e rinovuar të përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC ‘Antena’ brenda datës 8.2.2028.”.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022, në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar germën “g”, të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerjeje, kontrata qiramarrjeje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerjeje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, pjesa e pikës 2, të vendimit nr. 195/2018, i ndryshuar, e cila lidhej me kontratën e qirasë me Bashkinë Mat, nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator.

- Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.

- Në përputhje me nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, vlerësohet se pika 2, e vendimit nr. 95/2018, të ndryshuar, duhet të ndryshohet, duke lënë në fuqi vetëm detyrimin për depozitim të lejes së rinovuar të përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka

kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, të ndryshuar, duhet të ndryshohet.

- Ky ndryshim është i nevojshëm për të harmonizuar vendimin nr. 195/2018 me kuadrin e përditësuar rregullator dhe për të siguruar qartësi në kushtet e licencës së shoqërisë “Derbi-E” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 195, datë 30.8.2018, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet: “Shoqëria “Derbi-E” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Antena” brenda datës 8.2.2028.”.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “FTL” sh.a. dhe “OSSH” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti